



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARIMIT PRIVAT
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT ELVIN HOXHA
CERTIFIKATE NR.206/JANAR 2015 NIPT.L42109004H

Adresa: Rruga "Vaso Pasha" Nr.13/1, Ap.1, Tirane

E-mail: elvinth@hotmail.com Mob: +355682029920

Nr.126/17

Nr. 607 Prot.

Tiranë më datë 3/3/2017

URDHËR

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QËNDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

Per Dijeni : Debitorit , Shoqëria "MEDIA MOTIV" sh.a , Nr.Nipt K57206002M
Kreditorit, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)

Prane meje Permbaruesit Gjyqesor Privat Elvin Hoxha eshte depozituar kerkesa e pales kreditore Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) sëbashku me Titullit Ekzekutiv Vendim Gjorbë nr.31, datë 03.08.2016 të Grupit të Inspektimit të AMA-s në masën 1.000.000 (njermilion) lekë, të vendosur ndaj shoqërisë Shoqërisë "MEDIA MOTIV "sh.a me Nipt K57206002M për subjektin televiziv OSHMA "TV ROZAFI MOTIV " sëbashku me Urdhër Ekzekutimi Nr.2650 datë 19.12.2016 lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me palë:

-Kreditor: Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)

-Debitor: Shoqëria "MEDIA MOTIV "sh.a me Nipt K57206002M
për subjektin televiziv OSHMA "TV ROZAFI MOTIV "

-Objekti: Lëshimi i Urdhërit të Ekzekutimit për sanksionin me gjorbë nr.31 datë 03.08.2016 të AMA-s të vendosur ndaj Shoqërisë "MEDIA MOTIV "sh.a me Nipt K57206002M për subjektin televiziv OSHMA "TV ROZAFI MOTIV "

KONSTATOVA :

Me Vendimin Nr.2650 datë 19.12.2016 të lëshuar nga Gjykata Administrative Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur:

- 1- Pranimi i kërkesës
- 2- Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për sanksionin me gjorbë nr.31 datë 03.08.2016 të vendosur ndaj Shoqërisë "MEDIA MOTIV "sh.a me Nipt K57206002M për subjektin televiziv OSHMA "TV ROZAFI MOTIV "

Referuar Vendimit të Gjorbës me nr. 31, datë 03.08.2016 , sanksionon subjektin e sipërpermendur me masën 1,000,000 (nje milion) Lekë

Ne kushtet kur per ekzekutimin e Vendimit Nr.2650 datë 19.12.2016 të lëshuar nga Gjykata Administrative Shkallës së Parë Tiranë, nuk eshte permbushur detyrimi ne menyre vullnetare , nga ana e Permbaruesit Gjyqesor Privat duhet te kryhet vendosja e mases se sekuestros konservative ne kuotat/aksionet e pales debitore Shoqëria "MEDIA MOTIV "sh.a me Nipt K57206002M



Si në zbatim të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile dhe ligjit nr.10031 , datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat” si dhe Nenit 39 te Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010” Per Kundervajtjet Administrative”

URDHEROJ :

1-Vendosjen e mases se sekuestros konservative ne kuotat/aksionet e pales debitore Shoqëria “**MEDIA MOTIV ”sh.a .me Nipt K57206002M** , si dhe mbi te drejtat qe rrjedhin nga zoterimi i ketyre kuotave duke ndaluar tjetersimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnje veprimi tjetër i cili mund te ndryshoje te dhenat ne regjistrin tregtar si dhe duke ndaluar tjetersimin e administratorit z.**Kristjan Kokaj** . Dokumentacioni do te qendroje i bllokuar deri ne nje urdher te dyte nga Permbaruesi Gjyqësor Elvin Hoxha .

Debitori : Shoqëria “MEDIA MOTIV ”sh.a .me Nipt K57206002M me administrator Kristjan Kokaj me adrese te ushtrimit te aktivitetit : Lagjia Vasil Shanto , Rruga Vaso Kadia , Pallati Fushaj , Kati 10 pranë tregut valutor

2- Per veprimet apo mos veprimet tuaja duhet te na vini ne dijeni shkreserisht brenda afatit ligjor

3- Personat qe behen pengese , do te pergjigjen ne baze te nenit 606 K.Pr.Civile (paragrafi II) qe parashikon vendosjen e sanksionit te gjobes dhe kallezimit penal.

4- Ky urdher mbahet ne disa kopje dhe u njoftohet paleve te cilat kan te drejten e ankimit ne Gjykate brenda 5 (pese) diteve.

**PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT
ELVIN HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË TIRANË

**URDHËR EKZEKUTIMI
NR. 2650, DATË REGJ 19.12.2016**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e përbërë nga gjyqtari:

BEZART KAÇKINI

Në Tiranë, sot më date 27.12.2016, mori në shqyrtim kërkesën që I përket:

- KERKUES:** Autoriteti i Mediave Audiovizive, (AMA) Tirane
- OBJEKTI :** Leshim i Urdherit të Ekzekutimit për sanksionin me gjobe nr. 31 date 03.08.2016 të AMA-s, të vendosur ndaj shoqërisë "Media Motiv" sh.p.k, për subjektin OSHMA "TV Rozafa Motiv" në masën 1.000.000 Leke.
- BAZA LIGJORE:** Neni 511, germa i Kodit të Procedurës Civile, Ligji nr. 49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", i ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës dhe akteve që i bashkëngjiten asaj

KONSTATOVA

Se me "Vendim Gjobe nr. 31 date 03.08.2016 nga Grupi Inspektimit të AMA-s Tirane në zbatim të Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në RSH", është vendosur masë administrative në vlerën 1.000.000 Leke ndaj shoqërisë "Media Motiv" sh.p.k, për subjektin OSHMA "TV Rozafa Motiv" për shkak të mosplotësimit të detyrimeve ligjore "Transmeton programe pa disponuar kontratë/marreveshje mbi të drejtat e transmetimit".

Ky vendim i është komunikuar subjektit dhe nga ana e tij nuk rezultoi të jetë kryer ankim administrativ apo gjyqësor ndaj tij.

Duke qenë se subjekti nuk e ka ekzekutuar vullnetarisht atë, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit.

Sa me sipër dhe referuar ligjit nr. 10279/2010 "Për kundërvajtjet administrative" ku vendim përbën titull ekzekutiv.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në bazë të neneve 511 e vijues të K.Pr.Civile, si dhe në ligjin nr. 10279/2010 "Për kundërvajtjet administrative",

VENDOSI

1. Pranim i kërkesës se kërkuesit Autoriteti i Mediave Audiovizive, (AMA) Tirane.
2. Lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për sanksionin me gjobe nr. 31 date 03.08.2016 të AMA-s, të vendosur ndaj shoqërisë "Media Motiv" sh.p.k, për subjektin OSHMA "TV Rozafa Motiv"
3. Kundër këtij vendimi nuk mund të ushtrohet ankim.

- U shpall sot në Tiranë date 27.12.2016

SEKRETARE

DENALDA MUÇAJ



GJYQTARI

BEZART KAÇKINI


